REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:109415
Datë:	01.10.2021
Numri i dokumentit:	02233150

Ac.nr.4483/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, nga gjyqtari individual Nehat Idrizi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores S. S. nga Prizreni, te cilin e përfaqëson Sh. K. nga Prizreni, përfaqësuesi i Federatës së Sindikatës së Punëtorëve Shëndetësor të Spitalit të Përgjithshëm, "Prim Dr.Daut Mustafa" në Prizren, e të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Sylejman Klinaku nga Prishtina, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr.Daut Mustafa" ne Prizren, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.799/20, të datës 20.05.2021, me datë 13.09.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr.Daut Mustafa" në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.799/20, i datës 20.05.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

-Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.529/20, i datës 14.04.2021, në pikën I (një) të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit, Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr.Daut Mustafa" ne Prizren i ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim, P.nr.2222/2020 të datës 16.07.2020 të Përmbaruesit privat Atip Mustafa nga Vushtrria dhe i njëjti Urdhër për Përmbarim mbete në fuqi. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje

2021:143339

juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila humb procesin gjyqësor-përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim bërë Gjykatës së Apelit, që t'a aprovoj ankesën si të bazuar duke e prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe t'a kthejë në rigjykim dhe rivendosje, ose të njëjtën t'a ndryshojë dhe ta refuzojë si të pa bazë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, ku ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 208 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i përmbarimit, përmbaruesi privat Atip Mustafa nga Vushtrria, me Urdhrin për përmbarim, 2222/2020 të datës 16.07.2020, ka lejuar propozimin për përmbarim të palës kreditore, S. S. nga Prizreni, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit, Spitalit të Përgjithshëm, "Prim Dr.Daut Mustafa" në Prizren, për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – Vendiit Administrativ, Nr.692/2020 të datës 14.05.2020 të Inspektoriatit të Punës në Prizren për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 637.33 euro në emër të kompensimit të pagave mujore, si dhe shpërblimit jubilar bazuar në përvojën 12 vjeçare.

Kundër urdhrit përmbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datë 27.07.2020, duke theksuar se urdhri në fjalë është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjor ndaj debitorit, pasi që Inspektorati i Punës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, pasi që pa administrimin e provave dhe pa kryerje të inspektimit brenda institucion me qellim të konstatimit të gjendjes faktike ashtu siç e parasheh ligji, ka vendos për këtë ankesë, pa nxjerrë fare raport zyrtar. Po ashtu në mesin e ankuesve ka ankues të cilët personalisht në mënyrë individuale kanë ushtruar ankesë në Inspektorat për të cilat ka vendosur ky i fundit çka do të thotë se për të njëjtin ankues dhe për të njëjtën çështje Inspektorati ka nxjerrë dy vendime. Tutje ka shtuar se duke marrë për bazë se Kontrata Kolektive Sektoriale e cila është lidhur në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatës së Shëndetësisë, i cili konstatim është cek edhe nga vetë ankuesi në ankesë, Inspektorati i Punës është dashur ta obligoj Ministrinë e Shëndetësisë për përmbushjen e këtij obligimi pasi që është nënshkruese e Kontratës e jo Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr.Daut Mustafa" në Prizren, si dhe vendimi i Inspektoratit të Punës, nuk mund të përmbushet sepse do t'i shkaktonte dëm të pa riparueshëm sepse i mungon buxheti e më gjerësisht me arsyet e dhëna si në këtë prapësim.

2021:143339

Përgjigje në prapësim ka paraqitur pala kreditore, ku ka propozuar që që prapësimi i palës debitorë të refuzohet si i pa bazuar, të vërtetohet Urdhri përmbarimor, P.nr.2222/2020 të datës 16.07.2020 i përmbaruesit privat, Atip Mustafa si dhe të detyrohet pala debitorë që t'ia paguaj borxhin kreditorit, shpenzimet.

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.799/20, të datës 20.05.2021, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbarim të një vendimi administrativ, si dokument i përmbarimit dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të LPP-së, dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, për veç se Ligjin për Përmbarimin e tillë është parapare me ligj kompetenca e organit tjetër, me kompetencën e gjykatës për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe që të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore që kane të bëjnë me kompensimet e tjera të punëtorëve dhe shërbyesve civil, bëhet fjalë në nenin 5 par.6 pika 2 të LPP-së, e dispozitat e të cilit ligj, zbatohen edhe për përmbarimin e vendimeve administrative derisa për bazën juridike për caktimin e përmbarimit në bazë të një vendimi administrativ dhe për plotësin e kushteve ligjore në rastet e tilla, bëhet fjalë në nenin 21, 22, neni 23 par.2 dhe neni 24 par.3 të LPP-së derisa për prapësimin si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbarimit bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së, kurse për shkaqet e parapara për prapsim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret pala kreditore propozimit për përmbarim, i'a ka bashkangjitur kopjen e noterizuar të vendimit administrativ, nr. 692/20 të datës 14.05.2020 të Inspektoratit të Punës në Prizren, i nxjerr në procedurën administrative, dhe i cili është dokument i përmbarimit, dhe se ky vendim administrativ, është bërë i formës së prerë me datën 03.07.2020, dhe ka të bëjë me kompensimin e pagave mujore si shpërblimit jubilar e bazuar në përvojën e punës në shumën prej 637.33 Euro.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në arsyetim e saj ka cekur se sa i përket pretendimeve të palës debitore në prapësim, se vendimi administrativ në fjalë, nuk mund të jetë titull ekzekutiv dhe se Inspektorati i Punës, nuk është organ kompetent për të vendosur për ketë natyrë të kërkesave në të holla-pagat jubilare nuk qëndrojnë pasi vendimi administrativ në fjalë, është bërë ekzekutiv dhe i formës së prerë në procedurën administrative dhe si i tillë është bërë i përmbarueshëm dhe në procedurën e përmbarimit.

Gjykata, ka cekur se në procedurën e përmbarimit, nuk mund t'a shqyrtoj ligjshmërinë e një vendimi administrativ pasi që kjo mund të bëhet në procedurën gjegjëse administrativo-gjyqësore e për më tepër kur dihet se procedura e përmbarimit, është procedurën e cila bazohet në parimin e rigorozitetit formal, kurse për çështjen e kompensimit të pagave jubilare për të punësuarit në sistemin e shëndetësisë, dhe kush e bënë kompensimin e tillë nga organi kompetent i shëndetësisë, bëhet fjalë në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, nr.03/L-212 të datës 01.11.2010,

derisa për kushtet ligjore për t'i dhënë pagat jubilarë dhe atë me rastin e pensionit behet fjalë në nenin 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë. Gjykata e shkallës së parë, sa i përket shpenzimeve procedurale ka vendosur në kuptim të nenit 13 të LPP-së lidhur me nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Vendimi i lëshuar nga Trupi Ekzekutiv i Inspektorati të Punës Nr. 692/20, i datës 14.05.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm prej datës 03.07.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet ne nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: "*Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative*" dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *"Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër"* e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *"Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë. "*, e po ashtu i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin ku përcaktohet se: "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*", andaj edhe pretendimet e debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbarimin.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit lidhur me atë se paga baze është llogaritur në mënyrë paushallë, si dhe pretendimi se të njëjtin nuk i takon shpërblimi për pagën jubilare, sepse gjykata në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor, vlerëson nëse janë

2021:143339

plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit për caktimin e përmbarimit dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë çështje juridike përmbarimore përmbarimi është lejuar në bazë të Vendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës Nr.692/20, i datës 14.05.2020, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm prej datës 03.07.2020, i cili i plotëson kushtet për përmbarim dhe është i përshtatshëm për përmbarim.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar prapësimin e debitorit ngase sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore përmbarimi lejohet në bazë të dokumentit përmbarimor, andaj edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.4483/21, data 13.09.2021

Gjyqtari Individual
Nehat Idrizi